



UNMIK



IPVK

---

**INSTITUCIONET E PËRKOSSHME TË VETQEVERISJES  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT**

**QEVERIA E KOSOVËS/ MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
VLADA KOSOVA/ MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA  
GOVERNMENT OF KOSOVA/MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL  
DEVELOPMENT**

Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural , duke u bazuar në:

Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/19 të datës 13 shtator 2001 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, neni 1.3 pika (d) dhe të Ligjit për Pyjet e Kosovës Nr. 2003/3 të datës 20 mars 2003 , në bazë të nenit 29.1

Nxjerr sa vijon:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV MA - Nr 02/2005  
PËR PËRGJEGJËSITË DHE OBLIGIMET E ROJEVE TË PYJEVE**

**KAPITULLI I  
DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME**

**Neni 1**

Me këtë Udhëzim Administrativ rregullohen:

- detyrat dhe përgjegjësitë për ruajtjen e pyjeve,
- detyrat e rojës së pyjeve,
- veprimet kundërligjore në pyje,
- uniforma zyrtare,
- kartela legjitimuse,
- mbajta dhe përdorimi i armës,
- ditari i punës dhe libri i cungjeve
- kualifikimin te cilin duhet ta ketë roja e pyllit.

**Neni 2**

Mbrojta e pyjeve bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit për Pyjet e Kosovës, aktet nënligjore dhe dispozitave të këtij Udhëzimi Administrativ.

## **Kapitulli II**

### **DETYRAT DHE PËRGJEGJËSIT**

#### **Neni 3**

1. Ruajtja e pyjeve bëhet me qëllim të mbrojtjes së pyjeve si resurs kombëtar, nga shfrytëzimi ilegal, dëmtimi, shkatërrimi dhe formate tjera të shfrytëzimit jo ligjor të pyjeve.
2. Organizimi i mbrojtjes së pyjeve ka për qëllim mbrojtjen e pyjeve nga zjarri, dëmtuesit dhe sëmundjet me origjinë fitopatologjike dhe entomologjike.
3. Ruajtjen e pyjeve nga prerjet ilegale në të cilën ekziston e drejta e pronësisë e bëjnë pronarët e pyjeve në pajtim me ligjin.

#### **Neni 4**

Roja i pyjeve është përgjegjëse për ruajtjen e pyjeve dhe kafshëve të egra, në territorin e caktuar, dhe territoret tjera sipas nevojës dhe urdhrit të personit të cilit i përgjigjet në pajtim me Ligjin dhe Udhëzimin Administrativ mbi përkrahimin e vendeve të punës në APK.

#### **Neni 5**

1. Rajonet e mbrojtjes i cakton Udhëheqësi i Zyrës së APK-së, në bashkëpunim me përgjegjësit e njësive komunale të APK-së, me pëlqimin e Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencionit Pyjor të Kosovës.
2. Rajoni mbrojtës për një roje pylli mund të jetë prej 500 gjeri në 1500 ha, varësisht nga konfiguracioni i terrenit, rrezikueshmëria e dëmtimit të pyjeve, strukturës pyjore dhe rrethanave tjera specifike për mbrojtje.
3. Regjistrimi i dëmeve dhe shkatërrimi i pyjeve dhe kafshëve të egra në rajonet e caktuara është i obliguar së paku njëherë në vite dhe pas çdo pranimit dorëzimi të terreneve.

## **KAPITULLI III**

### **DETYRAT E ROJTARIT TË PYJEVE**

#### **Neni 6**

Rojtari i pyllit është përgjegjës dhe ka për detyrë;

- a) të ruaj nga vjedhja, shkatërrimi respektivisht dëmtimi trungjet e prera dhe të paprera si dhe pjesët e drunjtë në pyje, kulturat pyjore, (pyllëzimet), tokat pyjore dhe prodhimet pyjore jodrunore,
- b) të ruaj nga shkatërrimi rrugët pyjore, depot e përkohshme, objektet pyjore të informoi për uzurpimet e pyjeve, tokave pyjore dhe objekteve përcjellëse, të pengoj veprimet e tilla në kuadër të mundësisë dhe kompetencave të tija.
- c) të ruaj dhe përkujdeset për mirëmbajtjen e shenjave të kufijve të jashtëm dhe të mbrendshëm të pyjeve, të parcelave dhe njësive menaxhuese pyjore,
- d) të parandalojnë gjuetinë ilegale, mbrojtjen e kafshëve të egra dhe objektet në terrenet e gjuetisë me të cilat menaxhon APK.
- e) të kryej procedurën e qarkullimit të masës drunore dhe kontrollimin e transportit të prodhimeve drunore dhe jodrunore të pyjeve.

- f) në mënyrë të rregullt të përcjellë vëzhgimin hidrologjik dhe fenologjik, frytë shmërin e farës pyjore, paraqitjen e sëmundjeve, insekteve, dëmtuesve, fatkeqësive elementare, dëmtimet nga kafshët e egra, brejtësit dhe disa mekanizmave tjera, furtunave dhe vërshimeve, duke evidentuar dhe raportuar lidhur me këtë së paku njëherë në muaj.
- g) të zbatoj planin e masave të përcaktuar në mbrojtjen preventive të pyjeve nga zjarret, mirëmbajtjen e pikave vrojtuese , vendosjen e shenjave paralajmëruese dhe ndalesave.
- h) tek paraqitja e zjarreve pyjore apo ndezja e zjarreve të hapura me afër se 200m nga kufiri i pyjeve menjëherë duhet intervenuar , duke nënkuptuar këtu edhe shuarjen e zjarrit, dhe nëse i duhet ndihma duhet qe urgjentisht të informoi zyrën e APK-së, shërbimet komunale dhe territoriale zjarrëfikse ,si organet e emergjencës dhe të sigurisë.
- i) të ndalojë kullotjen ilegale, dëmtimet nga kullotja, nxjerrjen e gurëve, zhavorrit, rërës, dheut dhe deponimeve mbeturinave në pyje pa lejen e organit përgjegjës.
- j) të informoj me shkrim eprorin e drejtpërdrejt për veprimtarinë e tij.
- k) përveqë obligimeve të ruajtjes, është i detyruar qe të merre pjesë në punët e kultivimit të pyjeve sipas urdhrin të udhëheqësit të drejtpërdrejt.
- l) të ngrisë fletëparaqitje për veprimet ilegale të prerjes, nxjerrjes, grumbullimit, përpunimit të materialit drunor dhe jo drunor dhe të njëjtat të dërgojë në Gjykatat Kompetente.
- m) të konstatoj identitetin e personit të cilin e ka gjetur duke shkaktuar dëme në rajonin e vet të ruajtjes në bazë të dokumentacionit si letërnjoftimi apo dokumentet tjera përkatëse, gjësendet e tija me të cilat ka kryer veprën si dhe përkohsisht ta konfiskoi masën drunore të prerë.
- n) të mbajë (nëse mundet) personat nëse janë hasur në vendin e kryerjes së veprës penale, dhe sipas detyrës zyrtare të lajmërojë organin kompetent të policisë.
- o) rregullisht dhe në mënyrë të saktë të mbajë ditarin e punës për dëmet pyjore nga prerjet ilegale, sëmundjet, dhe dëmtuesit pyjor ku konstatohet vendi, koha, sasia dhe lloji i prerjes, vlera e dëmeve pyjore dhe të dhënat tjera.
- p) Kopja e ditarit në fund të çdo muajit i dërgohet Udhëheqësit të APK- së përmes shefit të njësisë komunale.
- q) të kontrolloj shfrytëzimin e pyjeve në parcelat dhe ngastrat e lejuara për shfrytëzim në pyjet publike dhe private dhe të merr masa ndaj shfrytëzimeve jashtë lejes apo veprimeve tjera ilegale.
- r) të bëjë zëvendësimin e rojtarit tjetër gjatë kohës së pushimit vjetor, pushimit mjekësor etj, me urdhrin e drejtorit të Zyrës.

## **KAPITULLI I IV**

### **VEPRIMET KUNDËRLIGJORE NË PYJE**

#### **Neni 7**

Veprimet kundërligjore konsiderohen:

- a) Prerja ilegale e trungjeve dhe pjesëve të tije,
- b) Marrja ilegale e asortimenteve të stivosura (paluara),
- c) Nxjerrja, shkatërrimi ose dëmtimi i fidaneve në fidanishtet e reja dhe fidanet në kulturat pyjore.
- d) Degradimi dhe devastimi i pyjeve,

- e) Kullotja ilegale dhe dëmtimi i lastarëve të trungjeve të reja,
- f) Ngritja e objekteve, ndërtimi i rrugëve, terrenet për skijim dhe infrastrukturës tjetër pa lejen e organit përgjegjës,
- g) Shkatërrimi dhe dëmtimi i rrethjeve, dhe shenjave kufizues, sinjalizues, ndalues në pyje,
- h) shkaktimi dhe nxitja – ndezja e zjarrit në pyjet, si dhe ndezja e zjarrit në largësi deri 200m prej kufirit pyjor.
- i) Vjedhja , dëmtimi ose shkatërrimi i prodhimeve jo drunore, si dhe vjelja dhe grumbullimi ilegal i tyre,
- j) Gërmitja e dheut, nxirrja e gurëve, zhavorrit , rërës, humusit në pyje dhe tokat pyjore pa leje të organit përgjegjës,
- k) Ndotja e pyllit dhe tokës pyjore,
- l) Hapja e rrugëve pyjore pa lejen e organit përgjegjës
- m) gjuetia nga personat të pa autorizuar konform Ligjit për Gjuetinë.

### **Neni 8**

1. Me prerjen ilegale konsiderohet prerja e trungjeve – drunjëve që bëhet në pyjet në të gjitha pronësit pa lejen e APK-së të cilat paraqesin kundërvajtje apo vepër penale.
2. Prerje ilegal konsiderohet gjithashtu dëmtimi, thyrja e majeve të drunjëve, prerja e degëve dhe pjesëve të tij, sharritja, përpunimi i prodhimeve drunore dhe jo drunore pa lejen e organit përgjegjës.

### **Neni 9**

Me marrjen ilegale të drunjëve konsiderohet shfrytëzimi i të gjitha llojeve të asortimenteve drunore të prerë, rrëzuar, gjysëm të rrezuar dhe të mbetur, pa lejen e organit përgjegjës.

### **Neni 10**

Heqja e lëvres së trungjeve, nxjerrja e ashklave, shpuarja me mjete të mprehta konsiderohet dëmtim pyjor.

### **Neni 11**

Veprime kundër ligjore në prodhimet sekondare të pyjeve nënkuptohen:

- a) Vjelja, shkulja, dëmtimi dhe shkatërrimi i prodhimeve jo drunore rërës, zhavorrit, gurëve bimëve pyjore dhe kafshëve.
- b) kullotjen dhe ngrënien e lendave të dushqeve ku është e ndaluar për kullotje.
- c) mbledhjen e gjethëve për ushqim të bagëtive, farës pyjore, kërpudhave , pa lejen e organit përgjegjës.

## Neni 12

Dëme të shkaktuara nga zjarret ose ndezjet e zjarrit në pyje konsiderohen:

- a) drunjtë e djegur ose mbidjegur;
- b) drunjtë e prerë-rrëzuar në pyje të cilët janë djegur ose vlera e të cilëve është zvogëluar për shkak të djegësës;
- c) djegësja e filizave natyrore dhe pyllëzimeve pyjore të posangritura,
- d) stoqet e gjetheve të përgatitura për ushqim të bagëtive;
- e) shkatërrimi ose dëmtimi i rrethojës, shenjave kufizuese në pyje;
- f) dëmet tjera të funksionit të pyjeve dhe tokave pyjore.

## Neni 13

Vlera e dëmit të shkaktuar përcaktohet për çdo lloji të dëmit, dhe llogaritet sipas çmimoreve të përcaktuara.

## Neni 14

Gjatë përcaktimit të dëmit pyjor, në të njëjtën kohë të vlerësohen edhe pasojat të cilat janë shkaktuar ose mund të rrjedhin si dhe masat të cilat ndërmerren që ato të largohen apo parandalohen.

## Neni 15

Pas përcaktimit të veprimeve të kundërligjshme rojtari i pyjeve është i obliguar që:

- a) të vërtetojë llojin e dëmit, vëllimin, vlerën e dëmit të shkaktuar, vendin, parcelën ose ngastrën dhe kohën e kryerjes;
- b) që të siguroj materialin dëshmues mbi dëmin dhe personin që ka shkaktuar dëmin;
- c) pas konstatimit të prerjeve të kundërligjshme të drunjtëve rojtari është i obliguar të identifikoj dëmin përmes shijimit dhe damkimit të cungjeve me numrat rendor dhe çekanin për dëmet pyjore;
- e) përgatitë dhe dorëzon fletëparaqitjen për vepër kundërligjore, si dhe llogaritë dëmin pyjor të cilin e shprehë në masa përkatëse (m<sup>3</sup>, m', ha, copë, etj dhe në vlerë €.) në përputhje me Ligjin për pyjet dhe Udhëzimet Administrative.

## Neni 16

Vlerësimi i masës totale bëhet me tabela tarifore të përcaktuara me planet menaxhuese për pyjet publike, kurse për pyjet private dhe pyje tjera në bazë të tabelave tarifore të parcelave fqinjë.

## Neni 17

1. Nëse materiali drusor është i bartur, ndërsa cungu i drurit ka mbetur, diametri llogaritet në bazë të diametrit të cungut të drurit të prerë, duke marrë parasysh rënjën e diametrit (koeficientin e formës), dhe përdorimin e tabelave përkatëse.
2. Nëse cungu është i shkullur ose i djegur, elementet takstative për vlerësimin e dëmit merren sipas mesatares të parcelave për rreth.

## **Neni 18**

Të dhënat mbi personin që ka kryer veprimet kundërligjore përmbajnë: Emrin dhe mbiemrin, nofka, emrin e njërit prej prindërve, vendbanimin, e sipas mundësisë vitin dhe vendin e lindjes, profesionin, gjendjen pronësore, gjendjen martesore etj.. Nëse këtë e ka bërë i mituri, atëherë edhe të dhënat e babait, të ëmës ose tutorit (të kujdestarit).

## **Neni 19**

Si dëshmi për veprimet kundërligjore shërbejnë; dëshmitarët, mjetet e konfiskuara, fotografimi, gjurmët e mbetura e të ngjashme.

## **Neni 20**

Nëse vepra e kundërligjshme është bërë në pyjet e mbrojtura, parqet kombëtare, rezervate, llojet e mbrojtura drunore (llojet e rrezikuara), grumbujt farorë, pyllëzimet e të tjera, roja i pyjeve ka për obligim të specifikojë dëmet e shkaktuar në pyjet e mbrojtura, parqet kombëtare, pyllëzimet e të tjera.

## **Neni 21**

Regjistrimi i prerjeve joligjore (ilegale) bëhet duke vendosur numrin rendor dhe shenjen e çekanit në cungun e prerë. Numri rendor për secilin rajon të ruajtjes fillon çdo vit prej 1 dhe vazhdon më tutje. Me numrin rendor vendoset edhe shenja e çekanit të pyjeve të cilin e mbanë me veti rojtari i pyjeve. Me të njëjtin çekan në pjesën tjetër të tije damkoset edhe materiali i prerë ilegalisht, e që nuk është transportuar.

## **Neni 22**

Të dhënat e llogaritura mbi dëmin e shkaktuar regjistrohen në ditarin e punës dhe barten në librin e cungjeve. Nëse dëmi i konstatuar nuk është arsyetuar me fletëparaqitje nga pylltari përgjegjës, ngritët procedura disiplinore ndaj të njëjtit.

## **Neni 23**

1. Regjistrimi i dëmeve në rajonet pyjore bëhet së paku një herë në vite nga komisioni të cilin e cakton Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencionit Pyjor të Kosovës, si dhe pas çdo ndërrimi të rajoneve, pranimit dorëzimit, largimit, suspendimit apo vdekjes së rojtarit të pyllit.
2. Me regjistrimin e të dhënave në rajonet përkatëse vërtetohet dallimi i dëmeve faktike dhe dëmeve të arsyetuar me fletëparaqitje dhe nëse ndryshimi është më i madh se 20 m<sup>3</sup> në pyjet e larta (trungishte) respektivisht 10m<sup>3</sup> në pyjet e ultë (cungishte) pason ndërmarrja e masave disiplinore dhe masave tjera ligjore ndaj rojës së pyllit dhe personave përgjegjës.

## **KAPITULLI V**

### **KONTROLLI I PRERJES, TRANSPORTIT DHE QARKULLIMIT TË ASORTIMENTIT DRUNOR**

#### **Neni 24**

Rojtarët e APK-së janë të detyruar të bëjnë kontrollin e damkosjes, shijimit të trungjeve dhe qarkullimit të asortimentit drunor dhe prodhimeve tjera pyjore në pyjet publike dhe në pyjet private.

#### **Neni 25**

1. Kontrolli i prerjeve bëhet me verifikimin e ekzistimit të vulës pyjore (çekanit) në cungjet e asortimentit drunor të prera në bazë të lejes për prerje për parcela, ngastra përkatëse. Transporti është i lejuar vetëm me posedimin e dokumentacionit përkatës të lëshuar nga stafi i APK-ës
2. Asortimenti i cili transportohet apo vëhet në qarkullim të mëtejshëm duhet të jetë i vulosur me vula (çekanë) përkatës, duhet të ketë fletëpërcjellëse përkatëse (vendi i quajtur, numri i ngastrës, lloji i asortimentit, sasia, lloji i drurit, koha, nënshkrimi i personit përgjegjës dhe transportuesit, lloji i automjetit dhe targat e regjistrimit si dhe destinimi - relacion i transportit dhe detaje tjera të parapara me akte nënligjore.

#### **Neni 26**

1. Drunjte dhe prodhimet e tjera pyjore në qarkullim për të cilat nuk ekziston dokumenti i parashikuar ose nuk janë të damkosura në mënyrë të duhur, rojtari i pyjeve përkohësisht do të konfiskoj me procesverbal dhe i vendos në vendin e sigurt.
2. Për materialin e konfiskuar roja e pyjeve harton procesverbalin me të dhënat e nevojshme për personin të cilit i është konfiskuar materiali drunor dhe mjetet tjera , ku një kopje i dorëzohet kryesit të veprës.
3. Për veprimet e ndërmarrura si në piken 2 të këtij neni roja e pyjeve e informon shërbimin përkatës në Zyrën e APK-së dhe e ngritë procedurën gjyqësore.

## **KAPITULLI VI**

### **PRANIMDORËZIM I DETYRËS**

#### **Neni 27**

1. Me rastin e fillimit respektivisht përfundimit të kryerjes së punëve dhe detyrave në ruajtjen e pyjeve në rajonin pyjor të caktuar bëhet pranim dorëzimi në prani të komisionit të caktuar nga Shefi i Zyrës së APK-së. Komisioni për pranim dorëzimi të rajonit pyjor harton procesverbalin. Gjatë fillimit të kryerjes së punëve dhe detyrave të punës në ruajtjen e pyjeve në një rajon pyjor, përpilohet procesverballi mbi pranim-dorëzimin e detyrës për ruajtjen e pyjeve.

2. Procesverbali nga alineja 1 këtij neni përpilohet në 4 ekzemplarë nga të cilët nga një (1) ekzemplar i dorëzohet:
  - a) pranim – dorëzuesit të terrenit,
  - b) administratës dhe
  - c) arkivit.

## **KAPITULLI VII**

### **UNIFORMA ZYRTARE E ROJES SË PYJEVE**

#### **Neni 28**

Gjatë kohës së kryerjes së punëve të ruajtjes së pyjeve roja e pyjeve pajiset me uniform të cilën është i obliguar ta mbajë gjatë kryerjes së punëve zyrtare.

#### **Neni 29**

1. Dukjen, formën, ngjyrën, dhe kohëzgjatjen e bartjes së uniformës caktohet nga Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencionit Pyjor të Kosovës dhe stafi udhëheqës i APK-së.
2. Uniforma e rojtarit të pyjeve ka shenja të posaçme (emblemën) dhe shenja tjera identifikimi
3. Uniforma duhet të bartet vetëm gjatë punës zyrtare e kurrsesi jashtë orarit të punës zyrtare dhe e njëjta duhet të bartet e pastër dhe në rregull.
4. Roja pyjore me rastin e suspendimit, ndërrimit të vendit të punës, përjashtimit nga puna, shkuarjes në pension është e obliguar që ta kthej uniformën zyrtare.

## **KAPITULLI VIII**

### **FORMA DHE PËRMBAJTJA E KARTELËS SË IDENTIFIKIMIT TË ROJË SË PYJEVE**

#### **Neni 30**

Identiteti i rojtarit të pyjeve bëhet me kartelën zyrtare të identifikimit (në tekstin e mëtejme: kartela e identifikimit).

#### **Neni 31**

1. Kartela e identifikimit të rojës së pyjeve dhe stafit tjetër është rregulluar me Aktin nënligjor të lëshuar nga ana e MBPZHR.
2. Roja e pyllit gjatë kontrollimit me kërkesë të palës, inspektorit, policisë, prestarëve të KFOR-it dhe personave tjerë zyrtar është e obliguar ta tregoj kartelën e identifikimit.
3. Evidenca mbi kartelën e identifikimit të lëshuara rojeve të pyjeve dhe punëtorëve tjerë udhëhiqet në Ministri .

### **Neni 32**

Nëse roja e pyjeve e humbë kartelën e identifikimit ose në ndonjë rast tjetër mbetet pa të, është i obliguar që menjëherë e më së voni brenda 3 ditëve të informoj udhëheqësin e Zyrës.

### **Neni 33**

1. Nëse pushon e drejta e punës, rojtari i pyjeve, është i obliguar që menjëherë pas pranimit të vendimit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, të dorëzoj kartelën e identifikimit përgjegjësit të Zyrës i cili është i obliguar që të njëjtën ta dorëzoj në Ministri.
2. Së bashku me kartelën identifikuese, rojtari i pyjeve ka për obligim t'i dorëzoi edhe gjësendet e tjera me të cilat ka qenë i ngarkuar sikurse që është uniforma, damka pyjore, arma zyrtare, ditari i punës, fletëpërcjelljet etj.

## **KAPITULLI IX MBAJTJA DHE PËRDORIMI I ARMËS**

### **Neni 34**

1. Roja e pyjeve gjatë ruajtjes së pyjeve dhe vendeve të gjuetisë mund të jetë i armatosur me armë zjarri.
2. Për ruajtjen dhe mbrojtjen e pyjeve, kafshëve të egra, roja e pyjeve ka të drejt të mbaj pushkën apo revolen zyrtare konform ligjit për armët.

### **Neni 35**

1. Përcaktimi i llojit të armës bëhet në bazë të rrezikshmërisë së rajonit ekonomiko-pyjor dhe furnizimin me armë e kryen Ministria në bazë të lejes së organit kompetent dhe përmes procedurës ligjore.
2. Evidencën e ngarkimit me armë dhe municion e mban Ministria përkatësisht Administrata e Agjencionit Pyjorë të Kosovës.

### **Neni 36**

1. Arma dhe municioni barten vetëm gjatë orarit të punës. Numri i fishekëve të përdorur brenda 1 viti kalendarik, duhet të arsyetohet me shkrim në MBPZHR – APK.
2. Mos respektimi i bartjes së armës sipas paragrafit 1 të këtij neni, bartë përgjegjës in disiplinore dhe arma në procedurë i merret.

### **Neni 37**

Roja e pyllit ka për obligim që:

- a) armën dhe municionin ta ruaj dhe mirëmbajë me kujdes që e njëjta të jetë gjithmonë në gjendje të rregullt;
- b) arma ndalohet rreptësisht të përdorët në vende publike (apo çfarëdo gazmendi) dhe në ato vende ku mund të rrezikon shëndetin dhe jetën e personave të tret;
- c) armën të mos ia jep personave të tretë jo Kompetent.

### **Neni 38**

1. Roja e pyllit mund ta përdor armën vetëm në rastet e mbrojtjes së nevojshme të jetës së vetë apo të bashkëpunëtorëve.
2. Rojtari i pyllit ka për obligim që para përdorimit të armës t'ia tërheq vërejtjen personit i cili atakon personat nga paragrafi 1 të këtij neni.
3. Rojtari i pyllit i cili e ka përdor armën ka për obligim ta hartoi raportin me shkrim dhe në detale ta përshkruaj gjendjen e krijuar dhe t'ia dorëzoi Drejtorit të Zyrës së APK-së.

## **KAPITULLI X DITARI I PUNËS DHE LIBRI I CUNGJEVE**

### **Neni 39**

1. Roja e pyjeve është e obliguar që ta mbajë ditarin e punës dhe librin e cungjeve. Në ditarin e punës roja e pyjeve është i obliguar që ti regjistrojë dëmet e vërejtura dhe dukurit e rrezikimit të pyjeve nga zjarri, sëmundjet dhe dëmtuesit pyjor.
2. Libri i cungjeve është dokument në të cilën roja e pyjeve shënon të gjitha cungjet e gjetura që janë prerë pa vule(damkë).

### **Neni 40**

1. Ditari i punës dhe libri i cungjeve mbahet për çdo ditë. Një herë në muaj ditarin e punës dhe librin e cungjeve e kontrollon tekniku i angazhuar për atë terren.
2. Libri e cungjeve duhet të përmbajë numrin serik të faqeve dhe të jetë në dy kopje, njëra prej së cilës për çdo muaj i dorëzohet shefit të zyrës së APK –së përmes përgjegjësit të drejtpërdrejtë.

### **Neni 41**

Ditari i punës dhe libri i cungjeve regjistrohet në administratën e zyrës së APK -së dhe vërtetohet nga shefi i zyrës së APK-së.

## **Neni 42**

Nëse rojtari i pyjeve mban në mënyrë të parregullt ose nuk i mban fare shënimet në ditarin e punës dhe librin e cungjeve, bënë shkelje të rëndë të detyrave të punës për të cilat kundër tij ngritët procedura disiplinore. Për mos përcjelljen e lëshimeve të rojtarit të pyjeve nga paragrafi 1 i këtij neni përgjegjës in e mban përgjegjësi i drejtpërdrejt i njësisë ekonomiko - pyjor.

## **KAPITULLI XI**

### **KUALIFIKIMI SHKOLLOR I ROJËS SË PYJEVE**

## **Neni 43**

Rojtari i pyjeve duhet të posedojë përgatitjen e mesme shkollore të pylltarisë apo përgatitje tjetër të mesme.

## **Neni 44**

Përveç përgatitjes shkollore si në nenin 43 roja e pyjeve duhet ti plotësojë edhe këto kushte:

- a) të ketë aftësi të plotë fizike dhe psikike,
- a) të ketë shkathhtësi punuese ,
- b) të njohë punën dhe detyrat e rojës së pyjeve,
- c) të mos jetë i privuar nga e drejta për posedim dhe bartjen e armës zyrtare dhe
- e) kushtet të tjera të përshkruara për pozitën e rojës së pyjeve.

## **Hyrja në fuqi**

## **Neni 45**

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, më 04. 03. 2005

Zv. Ministri i Ministrisë së Bujqësisë,  
Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural  
Tomë Hajdaraj

-----